



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2020:066550

Datë: 06.05.2021

Numri i dokumentit: 01762217

**P.nr.07/21**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të pandehurit F. Z. nga Vushtrria, rr. “D. e K.”, për shkak të veprave penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1, pika 1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së shtetit PP.II.nr.260/19, të datës 14.01.2021, (2020:066550), në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur me datë 05.05.2021, në praninë e Prokurores së shtetit Natasha Taniq, të pandehurit F. Z. të dëmtuarve K. R. dhe B. T. pas shpalljes së aktgjykimit me datë 05.05.2021, përpiloh më datën 06.05.2021 këtë:

### A K T G J Y K I M

**I PANDEHURI F. Z.** nga i ati D. e ëma M. e vajzërisë M. i lindur me datë ..., me vendbanim në Vushtrri, rr. “D. e K.”, me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 363, paragrafi 1, pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK),

### REFUZOHET AKUZA

#### SEPSE:

**I.** Me datë 10.10.2015, gjatë natës, në rrugën magjistrale Mitrovicë- Prishtinë, tek lokali “K. P.”, në Vushtrri, i pandehuri F. Z. së bashku me të miturin J. B. me dashje, me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, duke e përdorur forcën me mjet të fortë dhe të përshtatshëm, kishin hapur derën e lokalit, duke depërtuar brenda në lokal dhe aty kanë marrë një burmashinë, të formës “B.”, në vlerë prej 100.00 euro, një frezë e dorës, e firmës “B.”, vlera 120.00 euro, një b. me firmën “M.”, në vlerë prej 65.00 euro si dhe dy b. pa firmë, në vlerë prej 100.00 euro, ashtu që të dëmtuarit K. R. i kanë shkaktuar dëme materiale. Në vlerë prej 358.00 euro.

- **Me çka do të kryente veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327, par 1, pika 1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

**II.** Me datë 13.10.2015, rreth orës 03:00, në rrugën “D. e K.”, në Vushtrri, të pandehurit F. Z. të miturit J. B. dhe E. M. me dashje, me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i sjellin dobi pasurore

të kundërligjshme, duke e përdorur forcën, me kubëza betoni, kanë thyer xhamat e dyqanit “I.”, e më pas, kanë depërtuar brenda në lokal, ku të njëjtit kanë marrë tre telefona mobil, dhe atë, një “I. 6”, ngjyrë hiri, në vlerë prej 699.95 euro, një “S. G. X6”, në vlerë prej 650.00 euro dhe një “S. A3”, ngjyrë e zezë, në vlerë prej 315.00 euro dhe para të imëta në kutinë humanitare, vlerë e cila nuk dihet, ashtu që të dëmtuarës F. M. i kanë shkaktuar dëme materiale, në vlerë prej 1,665.00 euro.

- **Me çka do të kryente veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327, par 1, pika 1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

**III.** Me datë 13.10.2015, rreth orëve të natës, në rrugën “Rr. T.”, në Vushtrri, të pandehurit F. Z. dhe i mituri J. B. me dashje, me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, duke përdorur forcën, me mjet të përshtatshëm, e kanë hapur derën e lokalit “K.”, duke depërtuar brenda në lokal, ku të njëjtit kanë marrë cigare të llojeve të ndryshme, në vlerë prej 500.00 dhe para të imëta, në vlerë prej 100.00 euro, ashtu që, të dëmtuarit B. T. i kanë shkaktuar dëm, në vlerë prej 600.00 euro.

- **Me çka do të kryente veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327, par 1, pika 1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

**IV.** Me datën 13.10.2015, rreth orëve të natës, në sheshin “Hasan Prishtina”, të pandehurit Fatos Zenuni dhe i mituri Jahir Bajrami, me dashje, me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, duke përdorur forcën, me mjet të përshtatshëm, kanë hapur derën e lokalit “Kafja e Vjetër”, duke depërtuar brenda në lokal, ku të njëjtit kanë marrë 20 pije energjike “Red Bull”, në vlerë prej 150.00 euro dhe të njëjtit, kanë tentuar, që nga muri të marrin televizionin plazma, të tipit “Samsung”, ashtu që, të dëmtuarit Arianit Maliqi, i kanë shkaktuar dëm material, në vlerë prej 150.00 euro.

- **Me çka do të kryente veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327, par 1, pika 1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Palët e dëmtuara, K. R. B. T. D. M. dhe A. M. udhëzohen në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

Shpenzimet e procedurës lidhur me këtë çështje penale, bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.260/19, të datës 14.01.2021, (2020:066550), me të cilin ka akuzuar të pandehurin F. Z. nga Vushtrria, rr. “D. e K”, për shkak të veprave penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par 1, pika 1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së shtetit PP.II.nr.260/19, të datës 14.01.2021, (2020:066550).

Prokurorja e shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 05.05.2021 ka deklaruar se, pas dëgjimit të dëshmitarit kyç E. M. në shqyrtimin gjyqësor të datës 12.04.2021, i njëjti ka deklaruar

se, avokati mbrojtës sipas detyrës zyrtare, nuk ka qenë prezent gjatë dhënies së deklaratës së tij, dhe se thëniet të cilat i ka deklaruar në atë deklaratë, nuk kanë qenë të sakta, sepse i njëjti vetëm e ka nënshkruar deklaratën, edhe sa i përket provave materiale me asnjë provë të vetme nuk mund të vërtetohet fajësia e të pandehurit si dhe të gjithë të dëmtuarit e propozuar edhe në cilësinë e dëshmitarëve të njëjtit kanë deklaruar se nuk e kanë parë të pandehurin vetëm e kanë përshkruar se si është kryer vepra brenda pasurisë së tyre, në këtë shqyrtim gjyqësor nuk është provuar me asnjë provë të vetme se i pandehuri F.Z. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj është tërhequr nga aktakuza PP.II.nr.260/19, e datës 14.01.2021, (2020:066550).

Palët e dëmtuara, në pajtim me nenin 463 të KPPK-së, janë udhëzuar në kontest të rregullt civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike

Në përputhje me nenin 454. par.1 të KPPK, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr.07/21, datë: 06.05.2021**

**Procesmbajtësja**  
**Bahrije Smakolli**

**GJYQTARI**  
**Agron Maxhuni**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.